**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova**

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals

Prishtinë,16.03.2020
Ref. 005/2020

Duke u mbështetur në nenin 59 paragrafi 1 dhe nenin 62 të Ligjit për Miniera dhe Minerale si dhe vendimin nr. 01/09 dt. 13.03.2020 dhe vendimin nr.01/11 dt. 15.03.2020, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale merr këtë:

**VENDIM**

1. Krijohet shtabi emergjent i KPMM-së i përbërë nga Bordi i KPMM-së, Drejtori i KPMM-së, Kryeinspektori i KPMM-së.
2. Pezullohet puna me palë deri në deri në vendimin e ri të Qeverisë së Republikës së Kosovës, KPMM nuk do të ofroj dhe pranoj asnjë shërbim përveç atyre emergjente.
3. Shtyhet shqyrtimi i aplikacioneve, kërkesave dhe ankesave deri sa të nxjerrët një vendim i ri nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
4. Shtyhet pagesa e obligimeve financiare të ndërmarrjeve në KPMM duke përfshirë këtu edhe interesit për vonesën.
5. KPMM do të ofroj mbështetje të vazhdushme për Korporaten Energjetike të Kosovës me qëllim të furnizimit stabil dhe të qëndrushëm me energji elektrike.
6. KPMM duhet ti njoftoj të gjitha Bankat dhe Kompanitë e Sigurimeve për ndaljen e garancionet dhe policat të cilave ju kalon afati gjatë kësaj kohe.
7. Obligohen Drejtori dhe Kryeinspektori i KPMM-së të caktojnë stafin emergjent.
8. Drejtori dhe Kryeinspektori janë të obliguar organizojnë dhe koordinojnë punën me të gjithë stafin nëpërmjet postës elektronike (e-mail).
9. Lejohet shfrytëzimi i veturave zyrtare nga anëtarët e shtabit dhe stafit emergjent për nevoja emergjente.

Ramiz Krasniqi
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS
DALJE
NR. PROT 1437
DD.MM.YYYY 16.03.2020
PRISHTINË/A

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë
**Tel:** +381 (38) 240 252
**Fax:** +381 (38) 245 844
**E-mail:** ICMM@kosovo-mining.org
**Ëeb:** ëëë.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo